



URDHËR

Nr. 4289 Datë 26/11/2015

PËR

PRISHJEN E SHOQËRISË “ KOMBINATI ENERGJITIK” SH.A, ELBASAN

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit I të Ligjit Nr. 8885, datë 22.4.2002, për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, datë 20.4.1995 “ Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshuar me akte të tjera ligjore, dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, për shkak të situatës së vështirë ekonomiko-financiare dhe humbjes së objektit kryesor të aktivitetit, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “ Kombinati Energjitik” sh.a Elbasan,

URDHËROJ:

1. Prishjen e shoqërisë “ Kombinati Energjitik” Elbasan dhe shpalljen e saj në likuidim.
2. Likuidator i shoqërisë emërohet Z. Kadri SALLA, aktualisht Administrator i kësaj shoqërie.
3. Të hartohet bilanci i likuidimit në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
4. Z. Kastriot Haxhaj, Ekspert Kontabël i Autorizuar, të kryejë certifikimin e Bilancit të likuidimit.
5. Ngarkohet likuidatori i shoqërisë për kryerjen e veprimeve përkatëse, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR